

## ZËMËR GURI / CUORE DI PIETRA

TEKSTI / TESTO: MICHELE BAFFA  
MUZIKA / MUSICA: MICHELE BAFFA

ARRANXHIMET MUZIKORE / ARRANGIAMENTI MUSICALI: ALESSANDRO PALOLI  
KËNDOJNË / CANTANO: MICHELE BAFFA e ANNA MARIA VITERITTI

Iktim ka dheu jonë me zëmren gur  
me sytë me lot e kurmin pjot me shpresë  
Kur na ishim sipër dejtit e ruajim qiellin  
ai ish i zi e retë na fjisjin drejt

Do të na thonë se nëng kish t'ikjim  
se atje na lëremi motra e vëllezër  
se vemi tek një dhe i zi  
ku na nëng njihemi me njeri

O Arbëri o Arbëri  
na dërgove jashtë e nëng na mbjodhe ti  
O Arbëri o Arbëri  
na dërgove jashtë e nëng na mbjodhe ti

Jetën tonë e shprishtim tek gjithë dheu  
u buartim e nëng gjëndemi më  
na vinjen ndër tru prindët tanë  
çë lëriem e forsi nëng i shomi më

Na ruami zogjtë çë ven e vinjen  
çë ngasen sipër dheut e dejtit  
doj' t'ishim edhe na si ata  
të rrijim bashkë, na me mëmë e tatë

O Arbëri o Arbëri  
mos na nxir shpresën e bën'e vimi aty  
O Arbëri o Arbëri  
na jemi arbëreshë e du'të vdesmi aty

Siamo partiti dalla nostra terra con il cuore di  
pietra  
con gli occhi pieni di lacrime e il corpo pieno di  
speranza

Quando noi eravamo sul mare e guardavamo il  
cielo  
il cielo era nero e le nuvole come se ci  
parlassero chiaramente  
Volevano dirci che non dovevamo andare via  
perchè lì lasciavamo fratelli e sorelle  
che eravamo diretti in una terra nera  
dove non conosciamo nessuno

O Arbëria o Arbëria  
ci hai mandati fuori e non ci hai più raccolti  
O Arbëria o Arbëria  
ci hai mandati fuori e non ci hai più raccolti

La nostra vita l'abbiamo sparsa per tutto il  
mondo

ci siamo persi e non ci ritroveremo più  
ci vengono in mente i nostri genitori  
che abbiamo lasciato e che forse non  
rivedremo mai più  
Vediamo gli uccelli che vanno e vengono  
che volano sopra la terra ed il mare  
vorremmo essere pure noi come loro  
per andare dove noi dovremmo vivere  
vorremmo essere pure noi come loro  
per stare insieme noi con mamma e papà

O Arbëria o Arbëria  
non toglierci la speranza e facci tornare  
o Arbëria o Arbëria  
noi siamo albanesi e vogliamo morire nella  
nostra terra